



Komunikatë

29. 09. 2009

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e vetë të 35-të të kryesuar nga Kryetarja znj. Nesrin Lushta, sipas rendit të ditës u njoftua me shkrim lidhur me aktivitetet e K.ryetares. Gjatë aktivitetëve javore, Kryetarja Nesrin Lushta, më datën 23.09.2009 është takuar me përfaqësues të Bashkësisë Ndërkombëtare dhe më 25.09.2009, me përfaqësuesen nga Departamenti i Ambasades Amerikane, e të cilët kanë shprehur interesimin dhe gatishmërinë për ta ndihmuar KQZ-në në procesin zgjedhor. Gjithashtu, më 26.09.2009, në emër të KQZ-së, Kryetarja Nesrin Lushta, e ka nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit me Ministrin e Arsimit, shkencës dhe Teknologjisë, z. Enver Hoxhaj. Kryeshefi i SKQZ-së, z. Xhemajl Peqani, ka informuar me shkrim KQZ-në lidhur me aktivitetet e SKQZ-së. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, e ka miratuar edhe raportin nga mbledhja nr. 33/2009.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, është informuar me rekomandimet e radhës nga Zyra për Regjistrim të Partive Politike për certifikim. Drejtoresha e ZRPP-s, Miradije Mavriqi paraqiti Rekomandimet për Çertifikim për 12 subjekte politike të cilat janë proceduar nga Zyra. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka miratuar rekomandimet e Zyres dhe, ka certifikuar këto subjekte prej të cilave, 8 janë parti politike, 3 janë inisiativa qytetare dhe, 1 koalicion. Numri i deritashëm i subjekteve të certifikuara, ka arritur në 49.

Zyra, ka njoftuar KQZ-në edhe për vendimin e caktimit të datës së hedhjes së shortit për renditjen e Subjekteve Politike në Fletëvotimin për zgjedhjet e 15 nëntorit. Data e hedhjes së shortit, do të bëhet më 2 tetor.

Kryeshefi i SKQZ-së z. Xhemajl Peqani, ka informuar KQZ-në lidhur me kërkesat për votim jashtë Kosovës. Ndërsa, lidhur me punën e Këshillave të KQZ-së, ka informuar Ilir Fetahu, kryesues i Këshillit për Operacioneve Zgjedhore. Pas dëgjimit, shyrimit dhe analizave të bëra, KQZ ka aprovuar rekomandimet e Këshillit për Projektin ECMI “Edukimi i Votuesëve në Komunitet e reja” dhe, rekomandimet për Projektin e IFES-it lidhur me publikimin e rezultateve preliminare të zgjedhjeve përmes SMS-ve.